



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2896/9 prot.

Datë 05.12.2023

V E N D I M
Nr.1266/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.12.2023 shqyrtoi kërkesën me:

Objekt: Modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-87708-11-15-2023, me objekt: “Monitorimi i treguesve mjedisor në njësitë e prodhimit” me fond limit 6,030,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 30.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë.

Ankimues: Operatori ekonomik “Tenuis Laboratories” SHPK me NIPT L81904506I dhe adresë: Rruga dytësore “Maminas-Sukth”, km 2

Operatori ekonomik “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK me NIPT L51512008E dhe adresë rruga “Irfan Tomini” Pallati 59, kati 1, nr. 6, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë me adresë: Rruga “Viktor Eftimiu”, Nr.12, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021

“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomikë ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi, se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK, ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, ndërsa operatori ekonomik “Tenuis Laboratories” SHPK nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 16.11.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-87708-11-15-2023, me objekt: “Monitorimi i treguesve mjedisor në njësitë e prodhimit” me fond limit 6,030,000.00 lekë pa TVSH,

parashikuar për t'u zhvilluar me datë 30.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë.

II.2. Në datën 21.11.2023 është paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ankesa me nr.2896 prot. e operatorit ekonomik “Tennis Laboratories” SHPK, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Me shkresën nr. 5787/3 prot., datë 24.11.2023, protokolluar me tonën me nr.2896/2 prot., datë 30.11.2023, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5. Referuar shkresës së sipërcituar të autoritetit kontraktor, rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Tennis Laboratories” SHPK dhe ka njoftuar Komisionin e Prokurimit Publik, se ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës dhe ku ndër të tjera, citohet: “[...] Në datën 22.11.2023 jemi njohur me anë të sistemit elektronik të Komisionit të Prokurimit Publik mbi ankesën e paraqitur nga shoqëria “Tennis Laboratories” SHPK mbi këtë procedurë.....Në datë 23.11.2023 është paraqitur pranë AK-së Formulari i Ankesës Nr. 5796 prot. [...]”

II.6. Duke qenë se, operatori ekonomik “Tennis Laboratories” SHPK ka paraqitur ankesë pranë KPP-së në datë 21.11.2023, por nga informacioni i autoritetit kontraktor ky i fundit shprehet, se e ka protokolluar ankesën e operatorit ekonomik “Tennis Laboratories” SHPK në datë 23.11.2023, KPP me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe shqyrtimit të të gjitha fakteve dhe rrethanave, me anë të shkresës nr.2896/3 prot., datë 01.12.2023, si dhe shkresës nr. 2896/4 prot., datë 01.12.2023, i kërkoi respektivisht operatorit ekonomik ankimues dhe autoritetit kontraktor të paraqisnin brenda datës 05.12.2023 pranë KPP-së dokumentacionin provues, që vërteton datën e dorëzimit të ankesës nga operatori ekonomik ankimues pranë autoritetit kontraktor, si dhe dokumentacionin provues të autoritetit kontraktor që vërteton datën e protokollimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Tennis Laboratories” SHPK pranë këtij institucioni.

II.7. Kërkesa për informacion si më sipër, iu dërgua autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik “Tennis Laboratories” SHPK edhe përmes komunikimit elektronik zyrtar (e-mail) më datë 04.12.2023.

II.8. Më datë 04.12.2023 përmes komunikimit elektronik zyrtar (e-mail), operatori ekonomik “Tennis Laboratories” SHPK ka dërguar në KPP informacionin e kërkuar, duke i bashkëngjitur e-mail-it edhe kopje të “Gjurmimit Postar” të objektit me KOD RR529217529AA, me anë të së cilës konstatohet, se objekti është dorëzuar në autoritet kontraktor në datë 23.11.2023. Ky

informacion u dërguar në KPP nga “Tenuis Laboratories” SHPK edhe përmes shkresës me nr. 61 prot., datë 04.12.2023 protokolluar me tonën me nr. 05.12.2023.

II.9. Në datën 22.11.2023, operatori ekonomik “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK, ka paraqitur ankesën me nr. 2917 prot., pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor, ankesa e operatorit ekonomik “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK, është paraqitur pranë autoritetit kontraktor më datë 22.11.2023.

II.10. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.11. Nëpërmjet shkresës nr. 5778/2 prot., datë 24.11.2023, protokolluar me tonën me nr. 2917/2 prot., datë 30.11.2023, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi për shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.12. Referuar shkresës së mësipërme të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK dhe ka vendosur pranimin e pjesshëm të saj konkretisht duke argumentuar:

“ [...] –Në lidhje me ankimin mbi kërkesën e AK-së që laboratorit të jetë në pronësi, ankimuesi kërkon shtimin e mundësisë për marrjen me qira. KSHA pranoi kërkesën e ankimuesit që të lejohet që operatori ekonomik ofertues të ketë në pronësi ose me qira laborator fiziko kimik të akredituar.

Për sa më sipër pretendimi i ankimuesit pranohet.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë listën e analizave për të cilat laboratorit është i akredituar të cilat duhet të jenë në përputhje me kërkesat sipas specifikimeve teknike. Në lidhje me këtë kriter ankimuesi pretendon se çdo laborator posedon metoda ose standarde të ndryshme për parametra të ndryshme në specifikimet teknike të hiqet metodat që janë vendosur për parametrat e lejes pasi lista e specifikimeve me metoda të vendosur është shkelje bazuar në Ligji Nr.162/2020 për prokurimin publik dhe VKM RPP 265 date 19/05/2021 i ndryshuar miratimin e rregullave të prokurimit publik. Kërkojmë që ky kriter të hiqet sepse është diskriminues dhe cenon konkurrencën e lirë.

KSHA pranoi kërkesën e ankimuesit që metodat dhe standardet të jenë analoge.

Për sa më sipër pretendimi i ankimuesit pranohet.”

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues, si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Në datën 16.11.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-87708-11-15-2023, me objekt: “Monitorimi i treguesve mjedisor në njësitë e prodhimit” me fond limit 6,030,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 30.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë.

III.1.1. Në datën 21.11.2023 është paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ankesa e operatorit ekonomik “Tenuis Laboratories” SHPK, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.1.2. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

III.1.3. Me shkresën nr. 5787/3 prot., datë 24.11.2023, protokolluar me tonën me nr.2896/2 prot., datë 30.11.2023, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor për procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.1.4. Referuar shkresës së sipërcituar të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Tenuis Laboratories” SHPK dhe ka njoftuar Komisionin e Prokurimit Publik, se ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës dhe ku ndër të tjera, citohet: “[...] Në datën 22.11.2023 jemi njohur me anë të sistemit elektronik të Komisionit të Prokurimit Publik mbi ankesën e paraqitur nga shoqëria “Tenuis Laboratories” ShPK mbi këtë procedurë.....Në datë 23.11.2023 është paraqitur pranë AK-së Formulari i Ankesës Nr. 5796 prot. [...]”

III.1.5. Duke qenë se operatori ekonomik “Tenuis Laboratories” SHPK, ka paraqitur ankesë pranë KPP-së në datë 21.11.2023, por nga informacioni i autoritetit kontraktor ky i fundit shprehet, se e ka protokolluar ankesën e operatorit ekonomik “Tenuis Laboratories” SHPK në datë 23.11.2023, KPP me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe shqyrtimit të të gjitha fakteve dhe rrethanave, me anë të shkresës nr.2896/3 prot., datë 01.12.2023, si dhe shkresës nr. 2896/4 prot., datë 01.12.2023, i kërkoi respektivisht operatorit ekonomik ankimues dhe autoritetit kontraktor të paraqisnin brenda datës 05.12.2023 pranë KPP-së dokumentacionin provues, që vërteton datën e dorëzimit të ankesës nga operatori

ekonomik ankimues pranë autoritetit kontraktor, si dhe dokumentacionin provues të autoritetit kontraktor, që vërteton datën e protokollimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Tennis Laboratories” SHPK pranë këtij institucioni.

III.1.6. Kërkesa për informacion si më sipër, iu dërgua autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik “Tennis Laboratories” SHPK edhe përmes komunikimit elektronik zyrtar (e-mail) më datë 04.12.2023.

III.1.7. Me datë 04.12.2023 përmes komunikimit elektronik zyrtar (e-mail) operatori ekonomik “Tennis Laboratories” SHPK ka dërguar në KPP informacionin e kërkuar, duke i bashkëngjitur e-mail-it edhe kopje të “Gjurmimit Postar” të objektit me KOD RR529217529AA, me anë të së cilës konstatohet, se objekti është dorëzuar në autoritet kontraktor në datë 23.11.2023.

III.1.8. Neni 24, pika 1, “Komisioni i prokurimit Publik” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

“Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij”.

III.1.9. Neni 30, pika 1, “Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera. Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik”.

III.1.10. Në nenin 110, pikat 1, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

“1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në

ditën e punës që vjen pas saj. *Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik*”.

III.1.11. Në nenin 111, pika 1 dhe 4 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. *Operatori ekonomik ankimes dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik.*

Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

2. *Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimesi është i detyruar t’i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.”*

Neni 112, pikat 1 dhe 2 të ligjit 162/2020 parashikon shprehimisht se: “1. *Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni. Nëse autoriteti ose enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, e refuzon atë si të pavlefshme.*

2. *Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik”.*

Në nenin 114, pikat 1 dhe 4, “Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. *Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.*

“4. *Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës”.*

Neni 115, “Trajtimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “*Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

c) *në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës”.*

Neni 118, “Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “1. Komisioni i Prokurimit Publik, në çdo kohë pas marrjes së ankesës dhe para lidhjes së kontratës, kur nuk vendos pezullimin, mund ta lejojë autoritetin ose entin kontraktor, me anë të një vendimi të ndërmjetëm deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, të vazhdojë procedurën e prokurimit nëse pezullimi dëmton tërthorazi interesin publik, autoritetin ose entin kontraktor ose ofertuesit.

2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësisht të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji;

b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin;

c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore;

ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji;

d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankese tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik”

III.1.12. Referuar bazës ligjore të sipërcituar Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, është 7 ditë nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në rastin konkret, afati i fundit për paraqitjen e ankesës në autoritetin ose entin kontraktor, si dhe njëkohësisht në Komisionin e Prokurimit Publik, referuar datës së publikimit të njoftimit të kontratës (16.11.2023), ka qenë data 22.11.2023. Në këtë kuadër, ankesa pranë Komisionit të Prokurimit Publik është paraqitur në datë 21.11.2023, brenda afateve ligjore të parashikuara të ankimit, ndërkohë që ankesa pranë autoritetit kontraktor referuar informacionit të këtij të fundit dhe vërtetuar përmes gjurmimit postar të vënë në dispozicion nga vetë operatori ekonomik ankimues, është protokolluar në datë 23.11.2023, pra jashtë afateve të ankimit.

Në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSh”, i ndryshuar, parashikohet se: “Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inician procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dhe dokumentacionit provues (“Gjurmimit Postar” të objektit me KOD RR529217529AA,) konstatohet, se objekti është dorëzuar në autoritet kontraktor në datë 23.11.2023. Pra operatori ekonomik ankimues “Tenius Laboratories” SHPK

me dokumentacionin e paraqitur provon, se ankesa është dorëzuar pranë autoritetit kontraktor në datë 23.11.2023, kur ndërkohë duhej të ishte dorëzuar pranë këtij të fundit jo më vonë se në datë 22.11.2023.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, sjell në vëmendje të ankimuesit nenin 111, pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon shprehimisht se: “*Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik*”. Në rastin konkret ankesa e operatorit ekonomik ankimues jo vetëm që nuk është dorëzuar njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, por rezulton, se pranë autoritetit kontraktor kjo ankesë është dorëzuar jashtë afateve ligjore të përcaktuara në nenin 110, pika 1 e LPP i cili parashikon se “*Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë*”.

Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nis ditën e publikimit të njoftimit të kontratës 16.11.2023 dhe përfundon në ditën e 7-të. Në rastin konkret data e publikimit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi është 16.11.2023, ndërkohë për ankesën e paraqitur nga ankimuesi pranë autoritetit kontraktor përmes shërbimit postar është data 23.11.2023, jashtë afatit 7 ditor të përcaktuar në ligj, duke mos u legjitimuar *ratione temporis*.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ligji *stricto sensu* ka parashikuar, se ankesa dorëzohet njëherazi, si pranë autoritetit ose entit kontraktor ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe është përgjegjësi e operatorit ekonomik ankimues, që të dorëzojë këtë të fundit njëherazi në të dyja institucionet, brenda afatit të parashikuar në ligj. Në rastin konkret nga provat e paraqitura nga autoriteti kontraktor, si dhe provat e paraqitura nga vetë operatori ekonomik ankimues, vërtetohet, se ankesa është paraqitur pranë autoritetit kontraktor jashtë afateve të parashikuara ligjore të ankimimit.

Në nenin 118, pika 2, gërma “a” të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se: “*Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji*”.

Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimimit në autoritet kontraktor, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.2. Lidhur me pretendimet e ankimuesit “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, para shqyrtimit në themel të tyre, në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, në të cilin parashikohet se “1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përgjithësisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre”, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet e ndërmarra nga autoriteti kontraktor gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, deri në fazën e dorëzimit të ofertave.

III.2.1. Në datën 22.11.2023, operatori ekonomik “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor, ankesa e operatorit ekonomik “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK është paraqitur pranë autoritetit kontraktor më datë 22.11.2023.

III.2.2. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

III.2.3. Nëpërmjet shkresës nr. 5778/2 prot., datë 24.11.2023, protokolluar me tonën me nr. 2917/2 prot., datë 30.11.2023, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi për shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.2.4. Referuar shkresës së mësipërme të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK dhe ka vendosur pranimin e pjesëshëm të saj konkretisht duke argumentuar:

“ [...] –Në lidhje me ankimin mbi kërkesën e AK-së që laboratorit të jetë në pronësi, ankimuesi kërkon shtimimn e mundësisë për marrjen me qera. KSHA pranoi kërkesën e ankimuesit që të lejohet që operatori ekonomik ofertues të ketë në pronësi ose me qera laborator fiziko kimik të akredituar.

Për sa më sipër pretendimi i ankimuesit pranohet.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë listën e analizave për të cilat laboratorit është i akredituar të cilat duhet të jenë në përputhje me kërkesat sipas specifikimeve teknike. Në lidhje me këtë kriter ankimuesi pretendon se çdo laborator posedon metoda ose standarte të ndryshme për parametra të ndryshme në specifikimet teknike të hiqet metodat që janë vendosur për parametrat e lejes pasi lista e specifikimeve me metoda të vendosur është shkelje bazuar në Ligji Nr.162/2020 për prokurimin publik dhe VKM RPP 265 date 19/05/2021 i ndryshuar miratimin e rregullave të prokurimit publik. Kërkojmë që ky kriter të hiqet sepse është diskriminues dhe cënon konkurrencën e lirë.

KSHA pranoi kërkesën e ankimuesit që metodat dhe standartet të jenë analoge.

Për sa më sipër pretendimi i ankimuesit pranohet.”

III.2.5. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.6. Në nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e

parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Autoriteti ose enti kontraktor administron të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi deri te zbatimi i kontratës, me qëllim kontrollin e zbatimit të ligjit.

3. Kur një ose më shumë autoritete ose ente kontraktore kanë nevojë për të njëjtat mallra, punime apo shërbime, atëherë ata, nëse marrin një vendim të tillë, mund t'ia delegojnë të drejtën e kryerjes së procedurës së prokurimit një autoriteti ose enti tjetër kontraktor.

4. Në autoritetin ose entin kontraktor caktohet personi përgjegjës për prokurimin, i cili administron në mënyrë të vazhdueshme procesin e prokurimit, si dhe ngrihet njësi prokurimi për çdo objekt që prokurohet. Personi përgjegjës duhet të kenë minimalisht një kualifikim sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik.

5. Të gjitha proceset e parashikuara në këtë nen zhvillohen nën mbikëqyrjen e titullarit të autoritetit kontraktor ose personit të autorizuar prej tij. Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, në kuptim të këtij ligji, është personi përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike.

6. Rregulla më të hollësishme për zbatimin e pikave 2, 3, 4 dhe 5 të këtij neni përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

III.2.7. Në nenin 74 “Dokumentet e tenderit” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor, në hartimin e dokumenteve të tenderit, përdor dokumentet standarde, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit publik dhe i vë në dispozicion falas në rrugë elektronike.

2. Autoritetet ose entet kontraktore, nëpërmjet mjeteve elektronike, ofrojnë akses të pakufizuar, të plotë dhe të drejtpërdrejtë pa pagesë të dokumenteve të tenderit, duke nisur nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës ose ftesës për shprehje interesi. Kur mënyra e thirrjes për konkurrim është një njoftim për ekzistencën e një sistemi kualifikimi, ky akses ofrohet jo më vonë nga momenti i dërgimit të ftesës për ofertë ose për të negociuar. Përmbajtja e njoftimit ose ftesës për shprehje interesi specifikon adresën e internetit, ku mund të gjenden dokumentet e prokurimit.

3. Kur nuk mund të ofrojnë akses të pakufizuar, të plotë dhe të drejtpërdrejtë pa pagesë, nëpërmjet mjeteve elektronike, të disa prej dokumenteve të tenderit, autoritetet kontraktore ose entet mund të përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi se këto dokumente tenderi do t'u vendosen në dispozicion nëpërmjet mjeteve të ndryshme nga ato elektronike. Në këtë rast, afati për dorëzimin e ofertave zgjatet me 5 ditë.

4. Në rastet kur objekti i prokurimit nuk zhvillohet me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor, me kërkesë të operatorëve ekonomikë, duhet të vërë në dispozicion të të interesuarve dokumentet e tenderit, kundrejt pagesës, me një çmim i cili nuk duhet të tejkalojë atë që është e nevojshme për të mbuluar shpenzimet për kopjimin e dokumenteve të tenderit. Në çdo rast, emrat

dhe numri i operatorëve ekonomikë, që kanë shfaqur interes për blerjen e dokumentacionit të tenderit apo këqyrjen e tij, duhet të mbahen sekret.”.

III.2.8. Në nenin 114 “Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre. 2. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.

3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:

- a) pranimin e plotë të ankesës;*
- b) pranimin e pjesshëm të ankesës;*
- c) refuzimin e ankesës.*

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor, të kryera në zbatim të vendimit të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik.”.

III.2.9. Në nenin 115 “Trajtimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

- a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:*

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

4. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor nuk ka marrë vendim sipas përcaktimeve të nenit 114 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik menjëherë, por, në çdo rast, jo më vonë se 3 ditë nga mbarimi i afatit të mësipërm, i kërkon dërgimin e informacionit apo dokumentacionit përkatës.

Në këtë rast, autoriteti ose enti kontraktor, brenda 3 ditëve nga marrja dijani, ka detyrimin të paraqesë në Komisionin e Prokurimit Publik informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar.

Për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, Komisioni i Prokurimit Publik merr vendim jo më vonë se 30 ditë pas marrjes së informacionit apo dokumentacionit nga autoriteti ose enti kontraktor.

Për procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është jo më vonë se 20 ditë.

5. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës Komisioni i Prokurimit Publik ka nevojë të kërkojë ekspertizë nga palë të treta ose të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 4 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Afati për marrjen e vendimit nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.

Në çdo rast Komisioni i Prokurimit Publik ka detyrimin të vërë në dijani palët.”.

III.2.10. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se ndër qëllimet kryesore të ligjit të prokurimit publik janë ai i sigurimit të një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik dhe sigurimit të integritetit, besimit publik dhe transparencës në procedurat e prokurimit publik.

Ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces. KPP-së bazuar në kthimin e përgjigjes së autoritetit kontraktor, i rezultoi se ai e ka pranuar pjesërisht ankesën dhe konkretisht për pretendimin e operatorit ekonomik: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë listën e analizave për të cilat laboratorit është i akredituar të cilat duhet të jenë në përputhje me kërkesat sipas specifikimeve teknike. Në lidhje me këtë kriter ankimesit pretendon se çdo laborator posedon metoda ose standarde të ndryshme për parametra të ndryshme në specifikimet teknike të hiqet metodat që janë vendosur për parametrat e lejes pasi lista e specifikimeve me metoda të vendosur është shkëlqë bazuar në Ligji Nr.162/2020 për prokurimin publik dhe VKM RPP 265 date 19/05/2021 i ndryshuar miratimin e rregullave të prokurimit publik. Kërkojmë që ky kriter të hiqet sepse është diskriminues dhe cenon konkurrencën e lirë.”* autoriteti kontraktor ka vendosur: *“KSHA pranoi kërkesën e ankimesit që metodat dhe standardet të jenë analoge. Për sa më sipër pretendimi i ankimesit pranohet.”*

Sa më sipër, KPP gjykon, se nuk mund të shprehet mbi themelin e ankesës, duke qenë se është plotësisht e pamundur të kryhet një vlerësim i drejtë i pranimin ose jo të pretendimit nga ana e autoritetit kontraktor. Autoriteti kontraktor ka qenë tërësisht i paqartë dhe konfuz në mënyrën se si është shprehur në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes, pasi kërkesa e vetë operatorit ekonomik ankimes është që të hiqen metodat që janë vendosur për parametrat e lejes, si në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, ndërkohë autoriteti kontraktor shprehet që pranon kërkesën e ankimesit që metodat dhe standardet të jenë analoge. Nga shqyrtimi i përgjigjes së autoritetit kontraktor në lidhje me këtë kriter Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se pavarësisht se autoriteti kontraktor për këtë kriter shprehet se pretendimi i ankimesit qëndron, në thelb është e pamundur që të identifikohet nëse pretendimi është pranuar apo jo dhe si do të kryhet modifikimi i dokumenteve të tenderit për këtë pretendim në frymën e ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, sepse siç u theksua më lart mënyra se si është shprehur autoriteti kontraktor mbi pranimin e pretendimit të ankimesit është tërësisht konfuz dhe e paqartë, duke ndikuar drejtpërdrejt në konfuzionin e hapave të mëtejshëm të procedurës, sic është procesi i vlerësimit të ofertave dhe shqyrtimit të ankesave.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, lidhur me shqyrtimin nga ana e autoritetit kontraktor të pretendimeve të operatorëve ekonomik ankimes për dokumentat e tenderit gjatë fazës së publikimit të njoftimit të kontratës, si dhe shqyrtimi i këtyre pretendimeve në frymën e përcaktimeve të nenit 114 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në nenin 2 të tij, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Sa më sipër, KPP gjykon, se vendimmarrja e autoritetit kontraktor mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik është një akt administrativ në kuptim të Kodit të Procedurave

Administrative dhe në nenin 100 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” parashikohet se: “Akti administrativ i shkruar në letër ose elektronik, si dhe akti administrativ i konfirmuar, sipas nenit 98, pikat 2 dhe 3, të këtij Kodi, duhet të jetë i arsyetuar. **Arsyetimi i aktit administrativ duhet të jetë i qartë dhe përmban: a) shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë akti; b) shpjegimin e përmbledhur të rezultatit të hetimit administrativ dhe të vlerësimit të provave; c) bazën ligjore të aktit dhe një shpjegim pse kushtet ligjore për zbatimin e tij plotësohen në këtë rast; ç) në rastin e diskrecionit, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar.**”.

Akti administrativ i autoritetit kontraktor për trajtimin e pretendimit të operatorit ekonomik që të hiqen metodat që janë vendosur për parametrat e lejes, si në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, jo vetëm që është i paqartë në kuptim të Kodit të Procedurave Administrative, por nuk përmban as edhe një shpjegim të përmbledhur të rezultatit të hetimit administrativ dhe të vlerësimit të provave. Kjo paqartësi e trajtimit të ankesës për këtë pretendim ka sjellë pasoja juridike të cilat nuk mund të rregullohen me një vendimmarrje të ardhshme të Komisionit të Prokurimit Publik, pasi ky i fundit e ka të pamundur për të gjykuar, nëse në thelb pretendimi është pranuar apo jo dhe mbi mënyrën se si do të hartohen më tej dokumentet e tenderit të modifikuara mbi bazën e këtij pretendimi të pranuar nga autoriteti kontraktor. Gjithashtu, veprimet e mësipërme të autoritetit kontraktor dhe konkretisht të anëtarëve të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, kanë vendosur Komisionin e Prokurimit Publik në pamundësi për të zbatuar parashikimet e nenit 115 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

III.2.11. Në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit: “Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin”, nenit 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji përcaktohet shprehimisht: “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj.”. Në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “[...] Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [...]”. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se procesi i shqyrtimit të ankesës nga ana e anëtarëve të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave mbi mënyrën se si është shprehur në kthim - përgjigje në lidhje me pretendimin e ankimesit, e ku mbi bazën e të cilit do të kryhej edhe modifikimi i dokumenteve të tenderit është tërësisht konfuz dhe i paqartë, gjë që do të shkaktonte pasaktësi themelore në dokumentet e tenderit, ndaj përbën shkak për anulimin e procedurës së prokurimit, me qëllim trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se veprimet e sipërpërmendura janë haptazi jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, ndaj përbën shkak për anulimin e tyre. Në këto kushte, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe

në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi, duke hartuar kriteret për kualifikim, të qarta dhe të sakta në përputhje me nevojat dhe përcaktimet e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore të prokurimit publik.

III.3. Ndërsa lidhur me kërkesën e ankimesit, që të shtohet mundësia që laboratorit të merret me qira, KPP vëren se,

III.3.1. Nëpërmjet shkresës nr. 5778/2 prot., datë 24.11.2023, protokolluar me tonën me nr. 2917/2 prot., datë 30.11.2023, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi për shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.3.2. Referuar shkresës së mësipërme të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimes “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK dhe ka vendosur pranimin e pjesshëm të saj konkretisht duke argumentuar:

“ [...] –Në lidhje me ankimin mbi kërkesën e AK-së që laboratorit të jetë në pronësi, ankimesi kërkon shtimin e mundësisë për marrjen me qira. KSHA pranoi kërkesën e ankimesit që të lejohet që operatorit ekonomik ofertues të ketë në pronësi ose me qira laborator fiziko kimik të akredituar.

Për sa më sipër pretendimi i ankimesit pranohet.

.....”

III.3.3. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.*

III.3.4. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

III.3.5. Sa më sipër, referuar nenit 115 të Ligjit Nr. nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, vendos të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing”, lidhur me pretendimin më sipër dhe do të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pretendimet e tjera të paraqitura në ankesë.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” për pikën 2.3.2 të dokumenteve të tenderit, për të cilën kërkon: “heqjen e pjesës “Vlefshmëria e certifikatës së akreditimit duhet të jetë deri në përfundimin e kontratës objekt - prokurimi” KPP vëren se:

III.4.1. Në shtojcën 7 të dokumenteve të tenderit, Kapaciteti teknik, pika 2.3.2, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë laborator fiziko kimik të akredituar:

1. Sipas standardit S SH ISO IEC 17025:2017, për kryerjen e shërbimit objekt prokurimi.

2. Vlefshmëria e certifikatës së akreditimit duhet të jetë deri në përfundimin e kontratës objekt prokurimi.

Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën e akreditimit që të vërtetojë disponimin e laboratorit (në pronësi).

III.4.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”
Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.4.3. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.4.4. Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 i LPP-së parashikohet shprehimisht se:

1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

a) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*

c) *aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

2. *Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

3. *Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin*

informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.4.5 Ndërsa në nenin 39 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” përcaktohet se: “4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.4.6. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Komisioni vlerëson, se kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit, natyrën, aftësinë zbatuese, vlerën si dhe përmasat/volumin e kontratës. Në rastin konkret e rëndësishme për autoritetin kontraktor, referuar natyrës së kontratës është realizimi i objektit të prokurimit në përputhje me specifikimet teknike natyrën dhe përmasat e kontratës në fjalë. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë

kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, për sa i përket rastit konkret është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Referuar testit të proporcionalitetit vendosja e kriterëve nga ana e autoritetit kontraktor duhet të jetë në proporcion me objektin e prokurimit dhe në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Gjithashtu, duhet të ekzistojë një raport i arsyeshëm i kriterëve të vendosura dhe realizimit me sukses të kontratës. Parë në këtë këndvështrim, KPP gjykon, se vendosja e kriterit që vlefshmëria e certifikatës së akreditimit duhet të jetë deri në përfundimin e kontratës objekt – prokurimi, është kërkesë e ekzagjeruar, pasi e rëndësishme për autoritetin kontraktor është që të sigurohet që operatorët ekonomikë në momentin e hapjes së ofertave kanë certifikimet e kërkuara të vlefshme, pasi këto nga ana e tyre kanë një afat vlefshmërie të shtrirë në kohë të caktuar e cila jo domosdoshmërisht mund të mbulojë të gjithë periudhën e ekzekutimit të kontratës dhe ku përmes procedurës së riaplikimit para mbarimit të afatit mund të sigurojnë certifikatën e radhës me periudhën e caktuar të vlefshmërisë. Sa më lart, KPP e gjykon të ekzagjeruar kërkesën e autoritetit kontraktor që vlefshmëria e certifikatës së akreditimit duhet të jetë deri në përfundimin e kontratës objekt – prokurimi, pasi e rëndësishme është që certifikata të jetë e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave dhe për këtë fakt KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e saj.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

III.4.7. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” për pikën 2.3.4 të dokumenteve të tenderit për të cilin kërkon: *“Është vendosur dy herë i njëjti kriter pa një shpjegim të saktë ligjor/teknik nga AK. Kërkojmë heqjen e njëres nga dy pikat pasi krijon konfuzion dhe nuk kuptohet qëllimi i saj.”* KPP vëren se,

III.4.8. Në shtojcën 7 të dokumenteve të tenderit, Kapaciteti teknik, pika 2.3.4, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

2.3.4 (a) *Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij të paktën:*

-Minimalisht 1 (një) ekspert në fushën e mjedisit, inxhinier mjedisi ose agromjedisi. (Preferohet të jetë me eksperiencë të gjatë pune në këtë fushë);

-Minimalisht 2 (dy) ekspertë në fushën e kimisë. (Preferohet të jenë me eksperiencë të gjatë pune në këtë fushë);

-Minimalisht 1 (një) specialist në fushën e mjedisit, inxhinier mjedisi ose agromjedisi. (Preferohet të jetë me eksperiencë të gjatë pune në këtë fushë);

(b) Minimalisht eksperti ose specialisti në fushën e mjedisit, inxhinier mjedisi ose agromjedisi, duhet të jetë i pajisur me certifikatë për Vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor, lëshuar nga Ministria e Mjedisit.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë AK dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

- 1. Diplomë;*
- 2. CV;*
- 3. Certifikata;*
- 4. Listëpagesa E-Sig për periudhën Tetor 2023.*

III.4.9. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.4.10. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.4.11. Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 i LPP-së parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.4.12. Ndërsa në nenin 39 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” përcaktohet se: “4. *Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*”

III.4.13. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt - prokurimi. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese.

Në rastin konkret, lidhur me kërkesën e autoritetit kontraktor që operatori ekonomik të ketë në stafin e tij *-Minimalisht 1 (një) ekspert në fushën e mjedisit, inxhinier mjedisi ose agromjedisi. (Preferohet të jetë me eksperiencë të gjatë pune në këtë fushë).* si dhe *-Minimalisht 1 (një) specialist në fushën e mjedisit, inxhinier mjedisi ose agromjedisi.*”, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet në një test proporcionaliteti, së pari, nëse kërkesat në fjalë janë të përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesat në fjalë shkojnë përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. KPP gjykon, se në përgjigje të testit të mësipërm të proporcionalitetit, kërkesat e mësipërme nuk i shërbejnë synimit të autoritetit kontraktor dhe shkojnë përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit, për sa kohë autoriteti kontraktor ka kërkuar dy herë të njëjtin profil punonjësish (inxhinier mjedisi ose agromjedisi), edhe pse një herë e ka kërkuar në cilësinë e ekspertit dhe herën tjetër në cilësinë e specialistit. Në këtë mënyrë, KPP gjykon, se duke qenë se janë kërkesa për të njëjtin profil punonjësish ato nuk janë proporcionale me objektin e prokurimit prandaj autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për heqjen e njëres prej tyre.

Sa më lart pretendimi i operatorit ekonomik ankimes qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë

5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Tenuis Laboratories” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-87708-11-15-2023, me objekt: “Monitorimi i treguesve mjedisor në njësitë e prodhimit”, me fond limit 6,030,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 30.11.2023, nga autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë.
 2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing”, për procedurën e mësipërme të prokurimit.
 3. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysht konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.
 4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
 5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Tenuis Laboratories” SHPK.
 6. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK.
 7. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.
 8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro